



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0668

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi duke vendosur sipas ankesës së OE Agim Morina B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “112 Ndertimi i rrugeve në fshatin Mramor” me numër të prokurimit 616-24-3056-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 10/09/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Agim Morina B.I.” me nr. 2024/0668 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “112 Ndertimi i rrugëve në fshatin Mramor” me numër të prokurimit 616-24-3056-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës, ndërsa mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 18.06.2024.
2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 03.04.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “112 Ndertimi i rrugëve në fshatin Mramor” me numër të prokurimit 616-24-3056-5-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë

këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë me vlerë të parashikuar 100,000.00€.

Me datë 08.07.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Marisa ShPK & NSHT Victory Com”.

Me datë 11.07.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 16.07.2024.

Me datë 24.07.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0589.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë se arsyet për eliminimin e ankuesit sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar nga autoriteti kontraktues janë arsye të pabazuara. Njëkohësisht pretendon që tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për shkak se nuk ka përmbushur kërkesat teknike dhe profesionale sa i përket listës së stafit por edhe listës së pajisjeve/makinierisë. Po ashtu ankuesi pretendon se njëri nga anëtarët e grupit të operatorëve ekonomik nuk e ka dorëzuar çertifikatën e TVSH sipas DT. Konkretisht pretendimet ankimore të ankuesit janë formuluar si në vijim: *“AK arsyen e parë të eliminimit e ka cekur në njoftimin për vendimin e AK ku ne bazë të njoftimit ne nuk e kemi plotësuar ANEKSIN 7, konkretisht listen e projekteve të realizuara. SQARIM: Në ofertën që kemi dorëzuar, konkretisht nr. rendor 7. Kontratat Burimi, kemi paraqitur sakt dhe qart një listë të kontratave të cilat janë realizuar duke e përmbushur edhe kërkesën e dosjes se tenderit. Plotesimi i ANEKSIT 7 është i barazvlefshëm me Listen e Kontratave të realizuara nga kompania N.N.NT BURIMI/Agim Morina B.I, e cila është e nënshkruar dhe vulosur Pra mos plotesimi i ANEKSIT 7 nuk e ndryshon rrjedhjen e ofertës në përmbushjen e kërkesave të dosjes se tenderit meqenese te gjitha të dhënat në listën e kontratave janë të mjaftueshme për verifikim dhe qartësim te kontratave nga ana e AK. Aq me shum kur kjo list e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur në origjinal) nuk paraqet ndonje dem material për Mendojm se AK ka hapsir të mjaftueshme qe listen e kontratave të prezantuara nga ana jonë ta merr si të mirëqenë dhe si plotesim i kushteve të dosjen e tenderit. Rrjedhimisht ne nuk duhej eliminuar në këtë pik po duhej vazhduar si të përgjegjshem.*

Pra argumenti jonë në këtë pikë mendojm se është i qart dhe sqarues për AK. Tek 4. Udheheqesi i Meqenese ne kemi prezantuar Ing. e ndertimtarisë/Konstruktiv, AK ka mundur qe të kërkon informata sqaruese lidhur me vendimin për udheqes të punimeve. Sa i përket kërkesës 7. Të dosjes se tenderit, konkretisht Një (1) Ripper (Gremq), sqarojm se kjo paisje nuk ka nevoj te paraqitet ne listen e mjeteve sepse është pjesë përcjellese e eskavatorit, por si deshmi e kemi paraqitur faturën me nr. 8, Datë: 07.05.2011. Emertimi lugë (kova) vjen sipas regjistrimit ne doganë dhe nuk percaktohet nga ne. Pra paisja e cila kërkohet ne dosjen e tenderit është pjes e paisjeve tona dhe si te till ju sugjerojm edhe ta bëni një vizitë tek ne dhe të vertetohet kjo paisje. Sa i përket GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM i rekomanduar për kontrat nuk i ploteson kërkesat e DT dhe NJK për këto aryse: Tek Pika 2. Certifikata për regjistrim në TVSh Lidhur me Kete Pike OE-s , N.N.SH VICTORY COM i mungon Qertifikata e TVSH ,si eshte kerkuar ne DT. Tek pika 3.Menaxher i projektit (kontratës) Vërejtje Menaxheri duhet të jetë me profesion nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit – Drejtimi Konstruktivë; Diplomë universitare e programit Master (apo 4 vjetë e sipër, programi i vjetër në ; Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat; Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 12 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; • Certifikat për Siguri dhe Shëndeti ne Pune. Lidhur me këtë pik, GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM në ofertën e tyre kan prezantuar Ing. Ndërtimtarisë Beqë Hadërgjonaj duke mos prezantuar fare përvojën e punës përmes kontratave me punëdhënësin qe rrjedhimisht GOE të rekomanduar për kontrat nuk i ploteson kërkesat e dosjes se tenderit. Udheheqesi i punishtës Erblin Sopa-Ing i Ndertimtarisë/Konstruktiv, në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM e cila është prezantuar, nuk është e nënshkruar fare CV-ja e ing. ashtu siq është kërkuar ne Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, pra si e till duhet eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit meqenese nuk i përmbushë kërkesat. Gjithashtu krahasuar CV-në me REFERENCA ka mospërputhje të medha sepse ne CV-në e Ing. Erblin Sopa figurojn vetëm 8 muaj përvoj pune ndersa ne Referenca nuk figurojn vitet e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM në ofertën e tyre ka paraqitur Ing. I Komunikacionit i cili nuk i përmbushë kërkesat e dosjes se tenderit mbi përvojën e punës pasiqe në CV-në e prezantuar figurojn gjithsejt 4 vite e 1(një) muaj përvoj pune (Gusht 2019 – Gusht 2023, Kompania e Sigurimeve ‘‘SIGKOS’’) ndersa ka diplomuar në vitin 2019- Studimet i mbaroj me 27 dhjetor 2018 ndersa diplomoj me 7 shkurt 2019. Pra nuk i përmbush kërkesën e dosjes se tenderit. Tek pika 7.Lista e pajisjeve profesional të OE; Katër (4) Kamionë për transport; Një (1) Ekskavator për gërmim dhe ngarkim me goma 18-20ton; Një (1) Ekskavator për gërmim dhe ngarkim me zinxhir me pesh 18-20 ton Një (1)Mini Ekskavator me cekan me pesh 1- 1.5ton Një (1) Cilinder për vibrim 19 - 21 ton Një (1) Dozer (Bulduzher 18-20 ton Një (1) ; Një (1) Finisher • Një (1) Cilinder per asfalt gome-heker pesha 2- 2.5 ton; Një (1) Cilinder per asfalt heker heker pesha mbi 8 ton; Një (1) Ripper (Gremq) per eskavator me pesh 18- 20ton; Një (1) Ngarkues me pesh 5-6ton’’

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 28.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ndërsa me datë 08.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulon procedura në tersi në mungesë të ofertave të përgjegjshme”*.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues në raportin e tij ka gjetur se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme duke konfirmuar si të drejtë vendimin e autoritetit kontraktues për eliminimin e ankuesit nga ky aktivitet i prokurimit. Mirëpo njëkohësisht eksperti shqyrtues ka gjetur se edhe oferta e tenderuesit të rekomanduar sipas ekspertit shqyrtues i ka disa mangësi. Rrjedhimisht eksperti shqyrtues ka rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi. Konkresisht të gjeturat e ekspertit shqyrtues në raport janë elaboruar si vijon:

“Përgjigjeje në pretendimin nr. 1 - Duke e parë se GOE-ik ankues ka dorëzuar një listë të kontratave të nënshkruar dhe të vulosur së bashku me dëshmi e cila i përmban në tersi elementet e Aneksit 7 të dosjes së tenderit, sipas mendimit tim ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 2 - AK ka mundur ta sqaroj këtë pik duke e përdorur Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë të LPP –së dhe Rregullore Nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 38 Sqarimi i Tenderëve, andaj ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 3 - Sipas hulumtimit të bërë në internet dallimi mes Ripper (Gremq) dhe lugë (kova) del si:Dallimi kryesor mes ripper-it (gremqit) dhe lugës (kovës) qëndron në funksionin dhe përdorimin e tyre specifik. Duke e par në tersi pretendimin ankimor GOE ka mangësi në ofrimin e pajisjeve sipas s qarimeve të lartë përmendura dhe sipas kërkesës kërkesë në FDT andaj ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 4 - OE, N.N.SH VICTORY COM i mungon certifikata e TVSH –së sipas kërkesës së dosjes së tenderit andaj ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 5 - GOE i rekomanduar për kontratë nuk prezantuar kontrata/dëshmitë lidhur me përvojën e punës për kërkesën nr 3 sipas FDT-së. Andaj ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 6 - GOE ka prezantuar kontratën dhe referencën por ka një mos përputhje mes CV dhe referencave mos përputhja e mes cv –së dhe referencave mund të merret si devijimi i vogël nga AK e që të merret si devijimi është në diskrediton të plotë të AK –së. Ky pretendim ankimor është pjesërisht i

Përgjigjeje në pretendimin nr. 7 - Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 5 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës duke i parë këto mangësi në kërkesën e lartë përmendur ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 8 - Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 3 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës andaj duke u bazuar në ofertën të cilën eka prezantuar në platformën elektronik dhe mangësit të cilat janë evidente ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 9 - GOE ka ofruar draft kontratë NR. 22-04/2024 Dhënia e Mjeteve me Qira për makinerin si: Flshiner Greder, Cilinder asfalti e cila kontratë e ka një lëshim teknik tek investitori ku thuhet se është komuna e Gjakovës ndërsa elementet tjera brenda saj janë në harmonim me DT si nr i prokurimit emërtimi i procedure etj. Ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 10 si vazhdimësi e pikës 7 ku është kërkuar, tek Dëshmia e kërkuar dokumentare 7. Lista e pajisjeve profesional të OE. Aneksi 8 GOE –ik nuk e ka dëshmuar fare listën e pajisjeve dhe ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 11 si vazhdimësi e pikës 7 ku është kërkuar Një (1) Eskavator për gërmim dhe ngarkim me goma 18 - 20 ton nuk është prezantuar nga GOE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 12 - Një (1) Dozer (Bulduzher) 18-20 ton AK me datë: 24.05.2024 përmes B47-Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarime për pajisjen në fjalë dhe GOE me datë: 29.05.2024 është përgjigjur dhe ka ofrua DUD doganor me këto të dhëna: 2040 ZBD Prizren me të cilin e përmbush këtë pikë.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 13 - Një (1) Ripper (Gremq) për skavator me pesh 18-20 ton OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një kontratë për blerje si dëshmi dhe një foto kjo pikë është pjesërisht e bazuar ku ka ofruar disa fakt ku vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është në diskrediton të plotë të AK. (ndërsa dyshimeve që i ngri OE ankues si ekspert shqyrtues nuk mund të lëshohem në këtë pikë sepse nuk ja i thirrur për këtë pretendim).

Përgjigjeje në pretendimin nr. 14 Një (1) Cilindër për asfalt gome-hekur pesha 2-2.5 ton GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një DUD doganor lidhur me makinën në fjalë: Rul per sh trimin e rrugeve, vibratorë Makine ngjeshse-rulet e rrugeve e perdorure: Marka: DYNAPAC, Tipi:CC1100, Ore pune:1891 Kw:26.1, Viti prodhimit: 2011 dhe sipas hulumtimit në internat citoj hulumtimin: Tipi i makinës ngjeshëse DYNAPAC CC1100 është projektuar për përdorim në asfalt. Kjo makinë është ideale për ngjeshjen e shtresave të asfaltit në projekte të ndryshme të ndërtimit të rrugëve dhe trotuareve. Karakteristikat e saj kryesore, si manovrueshmëria dhe presioni i ngjeshjes, e bëjnë të

përshatshme për aplikime të tilla. Andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur që në rastin konkret nuk është aspak kontestues fakti që operatori ekonomik ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Ky fakt si i tillë është konstatuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar nga AK mirëpo është konfirmuar edhe nga eksperti shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin ekspertit shqyrtues në këtë pikë.

Sa i përket të gjeturave të ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues i ka falur vetëm pjesërisht besimin ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të detyruar autoritetin kontraktues që të anuloj në tërësi aktivitetin e

prokurimit. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin rekomandimit të ekspertit shqyrtues. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar në një aktivitet të prokurimit. Duke qenë se në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme as për të kthyer në rivlerësim por as për të anuluar aktivitetin e prokurimit si të tillë. Sa i përket pretendimit se njëri nga anëtarët e grupit të operatorëve ekonomik nga radhët e tenderuesit të rekomanduar nuk e ka dorëzuar çertifikatën e TVSH, vlen të thuhet që mungesa e çertifikatës së TVSH nuk është kusht administrativ. Përkundrazi, në rastet kur mungon ky dokument AK mund të kërkojë edhe sqarime shtesë nëse kjo konsiderohet e nevojshme. Kjo përcaktohet në këtë mënyrë edhe përmes pikës 10 në Udhëzuesin e Prokurimit Publik. Një rregullim i tillë është jo vetëm ligjore por edhe i logjikshëm kur merret parasysh fakti që mund të ekzistojnë operator ekonomik të cilët fare nuk janë deklaruar si pagues të TVSH dhe rrjedhimisht nuk posedojnë fare një çertifikatë të tillë. Mirëpo në rastin konkret, AK para se të procedoj me dhënien e kontratës duhet të sigurohet se tenderuesi i rekomanduar duke përfshirë të gjithë anëtarët e GOE, i plotësojnë të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë. Me këtë rast mund të kërkojen edhe vërtetimet tatimore nga tenderuesi i rekomanduar së bashku me çertifikatat lidhur me falimentimin si dhe çertifikatat për të kaluarën penale të udhëheqësve të anëtarëve të GOE. Ndërsa sa i përket pretendimeve të tjera të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe përgjigjen e AK përmes të cilës është kundërshtuar raporti i ekspertit shqyrtues. Në këtë përgjigje të AK ndër të tjera thuhet edhe si vijon “*Nuk pajtohem me përgjigjen e ekspertit shqyrtues për pretendimin 3. Operator Ekonomik Agim Morina nuk ka plotësuar disa makineri, ku ju si ekspert shqyrtues jeni përqendruar vetëm në një makineri dhe nuk keni përmendur që këtij Operatori i mungon buldozeri sipas FDT-së. Gjithashtu, i mungon edhe cilindri me peshë 2-2.5 ton sipas FDT-së, dhe si përfundim i këtij pretendimi, shtojmë se edhe riperi (gremqi) i mungon dhe se nuk është i njëjtë si kova ngarkuese dhe riperi, pasi ky ka rol tjetër në terren.*

Përgjigja e pretendimeve nr. 5-6-7-8, se Operatori Ekonomik i rekomanduar Marisa sh.p.k & N.Sh.T Viktory Com, ne si AK kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.05.2024 në lidhje me kontratat e stafit profesional, përkatësisht të inxhinierëve. Operatori Ekonomik Marisa sh.p.k & N.SH.T Viktory Com i është përgjigjur të gjitha pikave për të cilat është kërkuar që të dërgohen dokumente shtesë dhe sqarime në lidhje me Inxhinierin e Ndërtimit, Beq Hadergjonaj, ku ka prezantuar disa kontrata dhe referenca të kontratave dhe ka prezantuar edhe kontratat me autoritete kontraktuese për të cilat ka menaxhuar punimet, dhe si dëshmi, ju dërgojmë dokumentet e kërkuara nga AK.

Gjithashtu, Operatori Ekonomik i është përgjigjur edhe për udhëheqësin e punishtes, Erblin Sopa, për inxhinierin e Komunikacionit Egzon Tofaj dhe Gjeodetin Florent Retkocerin, ku kanë prezantuar kontratat dhe referencat në bazë të Sqarimit të datës 24.05.2024 dhe si dëshmi ju prezantojm Panelit. Të bashkangjitur në ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar, gjeni dëshminë për gjeodetin Haki Mehmeti, i cili është i certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe ka prezantuar çertifikatën e cila gjendet tek folderi 10, Lista e Punëtorëve të Certifikuar si dhe në folderin e stafit Profesional tek folder Haki Mehmeti”

Përgjigja e pretendimit nr. 10, se Operatori Ekonomik i rekomanduar Marisa sh.p.k & N.Sh.T Viktory Com nuk ka plotësuar Aneksin 8, nuk qëndron pasi që Operatori Ekonomik ka plotësuar këtë kriter i cili gjendet në dosjen e ofertuesit dhe është përshkruar kështu: "6.0 Referencat dhe kontratat.zip". Duke hapur këtë file, gjeni listën e projekteve dhe listën e makinerisë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, dhe si dëshmi ju paraqesim.

Përgjigja e pretendimit nr. 11, se Operatori Ekonomik i rekomanduar Marisa sh.p.k & N.Sh.T Viktory Com nuk ka plotësuar pikën 7 të makinerisë, nuk qëndron. Në bazë të listës së makinerisë të paraqitur nga Operatori Ekonomik, mund të kërkohet sqarim shtesë.

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të mbetet në fuqi vendimi i ngritur nga Autoriteti Kontraktues, Kuvendi Komunal Prishtinë, i cili ka bazë ligjore dhe fakte që ky vendim të mbetet në fuqi, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret për kontratë, dhe se eksperti nuk ka bërë shtjellimin e duhur në këtë ekspertizë, gjithashtu nuk ka paraqitur asnjë fakt dhe dëshmi për përgjigjet e dhëna”.

Paneli Shqyrtues vërtetoi gjendjen faktike gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dorëzuar në Eprokurim, përgjigjes së autoritetit kontraktues lidhur me këto pika në raportin e ekspertit shqyrtues pasi të njëjtat mund të konfirmohen edhe përmes dosjes së tenderit si dhe ofertës së tenderuesve në këtë aktivitet të prokurimit duke marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet vetëm si pjesërisht e bazuar mirëpo Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 08.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “112 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor” me numër të prokurimit 616-24-3056-5-2-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsytet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Agim Morina B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: